



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 13, datë 28.06.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin qershor, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:02

Data e mbajtjes së mbledhjes : 28.06.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Elio Jani dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar Këshilltarë! I nderuar Zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin qershor. Dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga Sekretaria e Këshillit.

Ftoj sekretaren të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... mungon.....deri tek.... Morena Boja...prezent....

Kryetar ke 33 këshilltarë në sallë.

(p.s. Hynë me vonesë në pikën 2 të R.D këshilltarët J.Mustafaraj dhe E.Laçi, pra 35 këshilltarë).

Ani Dyrmishi : Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN QERSHOR 2022
2. Informacion Këshilltarëve	INFORMACION PËR PUNËN E BËRË MBI PARANDALIMIN E DHUNËS MË BAZË GJINORE NË BASHKINË DURRËS
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DYTË PARAPRAKE TË 5 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONA VE TË REJA

Atëherë kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

Atëherë komente nuk ka.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?.... Nuk ka

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Klementina Meçi.

Klementina Meçi: Faleminderit Kryetar! Mirëdita të gjithëve!

Komisioni Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe vendosi që ta miratoj atë, dhe ta kaloj për miratim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente s'ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë **në pikën 2**, i jap fjalën drejtoreshës së Drejtorisë Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Durrës znj. Meme Xhaferaj të na informoj shkurtimisht për “Për punën e bërë mbi parandalimin e dhunës më bazë gjimore në Bashkinë Durrës”.

Meme Xhaferaj (drejtoresha DSHS): Lidhur me informacionin që në fakt ka të bëjë me punën e drejtorisë tonë, e cila mbulon pjesën e politikave dhe punës që bëhet për parandalimin e dhunës në familje, me politikat gjimore në nivel vendor, por gjithashtu dhe në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Në fakt për të folur dhe për të sjell informacion për çdo shërbim dhe për çdo

punë të bërë është një punë e madhe, që bëhet përditë. Kjo punë bëhet nëpërmjet specialistëve, nëpërmjet koordinatorit vendor, i cili koordinon gjithë punën për menaxhimin e rasteve, por gjithashtu dhe nëpërmjet qendrave që ofrojnë shërbime bazë komunitare, që kanë në fokus fuqizimin e individëve dhe të familjeve, kryesisht familje që kanë probleme të ndryshme social – ekonomike. Kështu që, unë jam munduar ta përmbledh pak dhe jam e hapur ndoshta dhe për ndonjë pyetje për të dhënë dhe informacion më të zgjeruar. Ligji bazë që “Ne” punojmë është ligji bazë 139 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe ligji nr.121 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, po kaloj shkurtimisht pa ju referuar data ..etj etj....

Bashkia Durrës për të implementuar politikat gjinore, që janë detyrime ligjore dhe ka miratuar “Planin e veprimit për barazinë gjinore”, i cili parashikon hapa konkret për të arritur nivelin e barazisë gjinore në nivel lokal. Ka qënë plani i parë në fakt, i hartuar në bashkinë Durrës por edhe në nivele kombëtare, pasi “Ne” kemi pas dhe mbështetjen e UNDP, për të thënë të vërtetën, e cila ka mbështetur si mekanizmin, që merret me gjithë koordinimin e veprimeve për dhunën në familje ashtu dhe për arritjen e politikave gjinore, pasi kryetari i mëparshëm z. Vangjush Dako firmosi Kartën Europiane, e cila bën detyrime dhe hapa konkrete që duhen merren në nivele lokale për arritjen e barazisë gjinore. Ai plan ka qënë 2018-2020 dhe tashmë ai plan ka mbaruar dhe jemi në fazën ku kemi hedhur hapat e para për hartimin e planit të ri të veprimit, i cili është ndarë, merret opinion nga drejtorët e gjithë bashkisë Durrës dhe më tej do të ndahet në organizatat e shoqërisë civile, pra në këtë fazë jemi për hartimin e planit të ri të veprimit.

Në bashkinë Durrës është ngritur dhe funksionon mekanizmi që koordinon gjithë veprimet për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, ku pjesë e këtij mekanizmi janë 11 institucione të cilat e kanë të detyrueshme nëse flasim për menaxhimin afatgjatë dhe afat mesëm. Në momentin që koordinatori vendor do të njoftohet nga policia për rastet e dhunës në familje ai menjëherë thërret grupin disiplinor që është një grup i ngushtë që ka përfaqësues nga drejtoria e shëndetësisë, por kryesisht mbledhen me policinë dhe me qendrat me të cilat ofron shërbimin që do të thotë lidhje telefonike, shërbimin psiko social apo shërbimin ligjor, i cili i ofrohet shërbim i menjëhershme apo menaxhimi i rastit nëse rasti ka nevojë të vendoset tek qendra e emergjencës. Këto janë ato aktor, të cilët janë për atë grupin e ngushtë se pastaj më tepër është grupi më i gjërë. Ky mekanizëm mbledhet në mënyrë të rregullt çdo muaj dhe tani ngaqë mbledhet shpesh se mbledhet si për mekanizmin e dhunës në familje, por edhe për fëmijë, sepse janë të njëjtët aktor i mbledhim së bashku e pastaj më tepër se një herë në muaj janë të menaxhimit të shpejtë, por një herë në muaj thirret.

Gjithashtu është dhe Komiteti Drejtues. Në vitin 2021 ka dalë dhe VKM e fundit 327-ta, e cila ka bërë përmirësime për këto mekanizma si Komiteti Drejtues, të cilin e kryeson kryetarja e bashkisë dhe janë gjithë drejtuesit e institucioneve rajonale pjesë e këtij Komiteti dhe pastaj në nivele teknike janë gjithë specialistët, që merren me menaxhimin e rasteve. Mbledhja me ndryshimet e reja ligjore që kanë ndodhur të Komitetit Drejtues përcaktohet se duhet të jetë brënda 3 muajve dhe përcaktohet qartë si duhet bërë njoftimi e gjithë procedurat me radhë dhe pastaj dhe problemet e grupit teknik.

Ndërkohë gjatë periudhës së gjëndjes së jashtëzakonshme tërmet, pandemi Ministria e Shëndetësisë nxori dhe protokollet e punës. Nga protokollet e para në fakt, që kanë dal për menaxhimin e rasteve si të dhunës, si të dhunës me bazë seksuale, si të dhunës ndaj fëmijëve dhe

këto protokolle pune bën që specialistët të bëjnë veprime të unifikuara dhe të standartizuara në lidhje qoftë si me vlerësimin e rastit, me menaxhimin, me referimin apo dhe mbajtjen e të dhënave, pra janë në mënyrë të detajuar.

Unë mund të sjell disa shifra se sa janë menaxhuar nga koordinatori vendor. Gjatë vitit 2021 janë menaxhuar 461 raste dhe nga të cilat 56 janë urdhëra mbrojtje (UM) dhe 405 janë urdhëra të menjëhershëm mbrojtjeje (UMM), ndërsa për vitin 2022 ky material është përgatitur para 1 muaji dhe thotë deri në prill, janë trajtuar 112 raste me urdhër të menjëhershëm mbrojtje, më fal 25 janë me urdhër mbrojtje dhe 57 janë me urdhëra të menjëhershëm mbrojtjeje, nga të cilët 4 janë monitoruar gjithmonë nga koordinatorët vendor. Nëse flasim për të gjitha këto raste “Ne” mund të them se të gjitha rasteve u ofrojmë gjithë shërbimet e nevojshme, por rasteve specifike, të cilat kanë probleme ekonomike, kanë probleme strehimi, kanë probleme punësimi, pra sipas vlerësimit që bën koordinatori vendor sigurisht, që marrin shërbimet e shpejta dhe pastaj shërbimet afatgjata që rastet trajtohen në tryezat teknike.

Gjithashtu bashkia nëpërmjet Ministrisë është krijuar Fondi Social, i cili është tashmë detyrim ligjor dhe për të ngritur, bashkitë e kanë që të aplikojnë përmes projekteve për të ngritur shërbime. Kështu që bashkia Durrës duke parë që kishte kërkesa të shumta me UM, me UMM dhe rastet sa vinin e shtoheshin ishte parë e nevojshme si nga bashkia, por edhe ndërkohë nga organizatat lokale ngritja e një qendre emergjente, e cila me thënë të drejtën na ka bërë të mundur që “Ne” të mundemi që të mbrojmë raste që kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme dhe mund të them sesa raste janë sistemuar në Qendrën e Shërbimeve Emergjente ku “Ne” marrim, nga viti në vit që fillimisht merrnim 90 % të fondit nga ministria, 60 % dhe vitin që vjen kemi marrë 30 dhe pjesën tjetër bashkia e ka kompletuar me buxhetet e veta, me qëllim që të fuqizohen bashkitë dhe ndërkohë të jenë të përgjegjshme për të menaxhuar vet shërbime të tilla. Tashmë këtë prag si të thuash e kemi kaluar, e kemi kaluar dhe në buxhetin afatmesëm. Ndërkohë jemi në partneritet me [Word Vision](#), e cila na ndihmon për të mbuluar nevojat ushqimore, shërbimet në qëndër, sidomos shërbimet e natës me kujdestar. Dhe për të qënë mënyrën sesi funksionin ky fond, fondi që vjen nga Ministria, “Ne” si bashki e menaxhojmë në rast të zërave, programit, projektit siç kemi aplikuar, ndërsa fondi nga [Word Vision](#), është një fond, i cili menaxhohet nga vet ato, ka kontraktuar kujdestarë me kohë, me orare sipas rasteve që sillen dhe janë tashmë praktika të para, që janë krijuar dhe neve na mundëson për planifikimin e buxheteve në të ardhmen nga bashkia Durrës.

Përveç shërbimit të emergjencës, se tashmë e kemi dhe detyrim, “Ne” punojmë për ofrimin e mbrojtjes së menjëhershme të rasteve të dhunës, por dhe integrimin e tyre. Gjithashtu “Ne” punojmë dhe në parandalim, jo vetëm gjatë, është bërë tashmë traditë që janë këto ditët e ndërjegjësimit kundër dhunës që zhvillohen nga 25 nëntori deri në 10 dhjetor. “Ne” këto aktivitete i kemi të vazhdueshme, sigurisht që bëjmë një kalendar të përbashkët për këtë periudhë, por dhe në aktivitete që bëhen nëpër shkolla në bashkëpunim me punojësit për mbrojtjen e fëmijëve, aktivitete që unë i përmenda që bëjmë në qendrat komunitare, se nuk është e thënë që të jemi vetëm “Ne” stafi i bashkisë që është në Drejtorinë e Shërbimit Social, por “Ne” punojmë dhe nëpërmjet qendrave që bashkia menaxhon, të cilat janë në komunitet dhe nëpërmjet organizatave të ndryshme kemi mundësi të zbatojmë projektet, të cilat fuqizojnë individin dhe familjen. Kur themi kështu që fuqizojnë individin dhe familjen, në fakt është një

punë e madhe që bëhet në këto familje, sepse sillen rregullisht, u flitet në mënyrë të rregullt për probleme të tilla që janë puna, sidomos edukimin e fëmijëve, shkollimin e fëmijëve e njësisë gjërash, e me pak fjalë shqetësuese për të gjithë komunitetin.

Unë mund t'i them nëse doni programet ditore që zhvillohen në Qendrën e Emergjencës, por nuk duhet t'ju marr kohën më shumë, sepse ky informacion është ndarë me ju. “Ne” menaxhimin e rasteve të dhunës, ofrojmë shërbim ligjor, linjë telefonike dhe shërbim psiko social e kemi në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim Kombëtar “Sot për të ardhmen”, por gjithashtu dhe me organizatën “Paqe, Gender dhe Siguri”. Ajo me fondet e veta, por dhe nga fondet nga projekte të ndryshme bashkëpunojmë për ofrimin e shërbimeve për rastet e dhunës në familje, por gjithashtu dhe në programe, që kanë në fokus ndërgjegjësimin komunitetit e sidomos të fëmijëve.

Në ligjin e ri që ka dal, për “Ne”, mbetet sfida tashmë, pjesa për të punuar me dhunuesit, se vërtet punojmë me viktimën por është detyrim ligjor që “Ne” të gjejmë programe, dhe mundësi projektesh për të thithur dhunuesit në projekte dhe për të punuar me ta. Kjo është një sfida e madhe në fakt që burrat të bëhen pjesë e këtyre programeve, shpresoj që nëpërmjet të ndonjë projekti të mundemi së bashku që këtë program ta fillojmë e ta zbatojmë në bashkinë Durrës.

Këto janë pak a shumë ato që “Ne” kemi bërë, ndërkohë për “Planin për Barazi Gjinore” që thamë është plani ri që po punohet , ajo do të lihet në fakt tek faqa e bashkisë pasi ta hartojmë plotësisht të marrim dhe opinionet e shoqërisë civile. Kështu që nëse do keni mundësi unë do ju njoftoj dhe me email dhe për të marrë dhe opinionet tuaja si anëtar të Këshillit Bashkiak.

Ani Dyrmishi : Atëherë faleminderit .

Nëse nga ana e këshilltarëve ka ndonjë pyetje lidhur me ç’ka tha znj. Xhaferaj?

Atëherë nuk ka pyetje.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 3** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi shqyrtoi pikën 3 të rendit të ditës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini : Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike vendosi unanimitisht për kalimin e kësaj pike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës zj. Velçani

Etleva Velçani : Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi mori në shqyrtim pikën 3 të rendit të ditës vendosi kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Velçani.

Kemi ndonjë koment përsa i përket pikës 3, nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 35 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit të ditës .

- **Diskutime**

Meqë rendi ditës përfundoi, në mbledhjen e kaluar është lënë një pyetje nga këshilltarja Morena Boja dhe ftoj Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore z. Luan Dajko për të na dhënë një përgjigje.

Kalo tek mikrofonin aty z. Dajko.

Luan Dajko (drejtor i DTTV): Përshëndetje të gjithëve !

Përsa i përket pyetjes zonjës apo zonjushës se kush e paraqet, po bëj një paraqitje të shkurtër qoftë dhe në emër të viteve që kam aty. Kemi pas një buxhet edhe pse jemi bashkia e 2-të e Shqipërisë të shpërfillur nga gjithë detyrimet dhe burimet e tjera ndër vite më parë. E kemi filluar me 800 milion lekë buxhetin dhe sot për vitin 2022 kemi një planifikim me 2 miliard e 027 milion lekë nga të ardhurat e burimeve të veta. Nuk marrë përsipër të them realisht domethënë, sepse kaloj shumë dhe konceptet e transfertave që merrim dikur. Transfertat kanë qënë të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Sot marrim transferta të pakushtëzuara dhe transferta specifike me afat të shkurtër ose të gjatë, burime të tjera që kemi ose të ardhura që kanë mbetur të cilat përdoren sipas destinacioneve të aprovuara.

Morena Boja: Doja të shtoja diçka, përsa i përket pyetjes. Unë jam Morena. Përshëndetje!

Unë jam ajo që kam kërkuar

Ani Dyrmishi : Morena të lutem një sekond. Ta mbaroj fjalën dhe pastaj.

Morena Boja: Okey në rregull. Po ta shkurtoja pak se pyetja lidhet me: Nëse keni një plan për të rritur të ardhurat e buxhetit të bashkisë?

Luan Dajko: Është buxheti më i madh që kemi planifikuar ndonjëherë ndër vite. Gjatë vitit të kaluar ka qënë 1 miliard e 794 milion lekë të reja dhe sivjet kemi planifikuar në buxhet prej 2 miliard e 027 e 023 milion lekë. Ku jemi mbështetur? Jemi rritur 13 % që në projektbuxhetin afatmesëm që “Ne” kemi çdo vit nga realizimet e 3 viteve të fundit paraardhës, të cilët janë si shëmbull për të ec përpara me burimet që kemi me realizimet që kemi faktike pa llogaritur problematikën që ka pas qyteti i Durrësit, sepse duhet të them se përpara se t’ju sqaroj për këtë punë vim pas 3 vitesh shumë të vështira për qytetin më të vështirë në Shqipëri, me tërmetin katastrofik që kaluam, i cili shkatërroi gjithë bizneset, me pandeminë dhe tani me luftën që ka ndodh në Ukrainë, por edhe me një fakt që askush që banon këtu nuk e kupton që 40 % të

subjekteve i kemi sezonal. Nga Gjiri i Lalëzit e deri tek Shkëmbi i Kavajës 40 % punojnë vetëm 2 muajt e verës që është për tu marrë në konsiderat në raport me të ardhurat, në raport me shpenzimet, në raport me strukturën që kanë, sepse përgjithësisht vinë të huaj shqipëtar nga Maqedonia, shqipëtar nga Kosova, që e marrin një vit, e një vit më mbropa nuk vinë për të ushtruar aktivitet, hotel apo restorant dhe resorte të tjera që kemi, që krijojnë vështirësi të jashtëzakondshme për pjesën e buxhetit. E thashë për parantezë, jo për t'ju treguar, por që jemi rritur 13 % në buxhet duke patur parasysh një qytet me problematik, një qytet që deri dje shpenzimet për pastrimin që është bërë kangrenë për qytetin kapnin vlerën e 395 milion, 400 milion lekë të reja kur “Ne” realisht me strukturën që kemi, “Ne” kemi rreth 14 mijë biznese në qytet nga të cilat rreth, domethënë 11 mijë afërsisht, më pak se 11 mijë, 10 mijë e 800 janë biznese të vogla dhe pjesa tjetër 3 mijë e 100 e ca janë biznese të mëdha. Çfarë ndodh? Realisht këto kanë ngel, që nuk arrinim dot të inkasonim në të ardhura bashkisë as 50 % të shpenzimeve që bënin, pra nuk mbulojnë kostot e shpenzimeve për pastrimin.

Kemi bërë një hap të jashtëzakondshëm në planifikimin e këtij buxheti duke futur taksën e popullatës. Kemi qënë nga 106 mijë familje që ka qyteti i Durrësit, 50 mijë familje nuk banojnë në qytet të madh. Është qyteti më emigrator në Shqipëri, të cilët realisht nuk kanë kontratë me ujësjellsin. Arritëm të bëjmë 40 mijë e 776 familje, të cilët janë banorë të qytetit nga 20 mijë që kanë qënë historikisht gjatë 20 viteve, me këtë sistem problematik që kemi patur sepse nuk arrim dot me fuqin që kemi, me burimet njerëzore, por dhe me burimet e tjera që kemi për të hedhur në sistem duke patur problematika të tjera të vështira siç janë hipoteka, një qytet që ka ndërtime ndër vite përpara, ka pas fluks të jashtëzakondshëm dhe janë pallate të pa hipotekuara. Një qytet ku ka rreth 35 mijë abonent që banojnë në qytetin e Durrësit dhe nuk janë familjar në gjëndjen civile, por që banojnë këtu për shkak sepse, po nga hipoteka kjo punë ligji 7501 nëse do bëhen banorë të qytetit të Durrësit i heq të drejtën e pronës aty ku se kanë marrë akoma dhe këto janë vështirësi të jashtëzakondshme për bashkinë dhe për strukturat që unë mbuloj, të jashtëzakondshme janë vështirësitë. Arritëm që pas kaq vitesh nga 20 mijë e 400 familje kryefamiljar që kemi patur me të ardhura shumë minimale për buxhetin e bashkisë, ta them këtu për taksat e popullatës, taksë ndërtese, pastrim, gjelbërim etj... edhe pse kemi ruajtur vlefte simbolike, edhe se përjashtohen kategoritë në nevojë, që janë pensionistë të vetëm, tetraplegjik, paraplegjik, kryefamiljar të vetëm me fëmijë, në nevojë e me halle, kemi arritur sot që po vazhdojmë dhe për një muaj saç është maksimumi në UKD, që e kemi dhe agjent tatimor me 75 mijë abonentë, nga të cilët 40 mijë e 776 janë banorë të qytetit dhe 35 mijë banojnë në Durrës dhe paguajnë taksat. Kemi bërë këtë planifikim buxheti për të shkuar 2 miliardë, sepse një shëmbull i thjeshtë, në vitin 20 kemi arkëtuar 47 milion lekë të reja nga taksat e popullatës në dhjetor të 21-shit 198 milion lekë, 4 fishin, shpresojmë dhe këtë vit dhe 200 milion lekë të tjera me 35 mijë abonentët e tjerë që kemi, në mënyrë që të realizojmë një buxhet me të ardhurat e veta të bashkisë duke sistemuar jo vetëm taksën e populates, që ka qënë problem dhe kangrenë për të ardhurat e shtetit, por duke ndjekur dhe një politik, e cila mendoj unë që sistemi fiskal, politikat shoqërore dhe njerëzore është gjëja më e bukur që kemi bërë. Qyteti i Durrësit ka ndjekur politikë e zgjerimit të bazës të biznesit, të luftës kundër informalitetit, por jo rritje taksash. Ndoshta mund të jemi bashkia më e mirë në Shqipëri edhe pse po arrijmë një buxhet me

13 % më tepër, që mos të rrisim taksat në një situatë të vështirë për 3-4 vjetësh, të cilat janë të papërballueshme për biznesin e vogël, i cili dominon me rreth 11 mijë.

Nuk është kaq e lehtë për të realizuar këtë buxhet në një qytet që ka problematika që jua parashtrova, që ka dhe 40 % të bizneseve që janë sezonal, por gjithashtu kemi bërë një specifikim shumë të mirë dhe një kontroll rrugës në vite të nivelit të tarifave. Kemi pas karburante që janë të ngarkuara me taksa të tjera dhe kemi rritur tarifën e pastrimit, kemi pas farmaci të cilat paguanin nga 50 mijë lekë të vjetra më pak se një byrektore 2 me 2, që jetonte dhe mezi nxirrte të radhurat e veta. Kemi sistemuar dhe kemi arritur pikërisht në nivelin 2 miliardë, nuk flas për transfertat dhe pjesë të tjera se janë pjesë e shtetit. Ajo që do kërkohet e nuk i dal dot zot, në kuptimin e shprehjes, është që gjithmonë është ruajtur një raport 60 % me të ardhurat e veta dhe 40 % nga transfertat nga qeveria, përkundra kësaj se nuk them që jam idem, pasojë e një qyteti që ka port, që ka tragetet, siç janë qytetet e tjera që marrin rentat minerare e të gjitha dhe përfitojnë nga minierat e nga të tjerat e Ne nuk përfitojmë asnjë lekë të vjetra nga këto punë. Qeveria e ka pa të arsyeshme duke qënë bashkia e 2-të më e madhe e Shqipërisë me problematikat e mëdha që kemi, me zgjerimin që kemi, pasi janë shtuar shumë shpenzimet, por jo të ardhurat. Po të shikosh nga Gjiri i Latëzit e deri tek Shkëmbi i Kavajës është 54 kilometra vijë uji dhe bizneset, që ekzistojnë janë të favorizuara se taksa e pasurisë sipas vendimit të qeverisë 132, datë 7.3.18 i kemi ulur 35 %, i kemi favorizuar bizneset nëpër fshatra qoftë dhe në raport me gjelbërimin , në raport dhe me shërbimet që ofrojmë sot, sepse ka prioritete në bashki, ka prioritete në zona që janë ato zona që kërkojnë shpenzime, kërkojnë investime ashtu siç do t'i vi radha dhe këtyre për të matur në ngarkesën fiskale që u bëjmë ish komunave të bashkive, pa llogaritur që kemi trashëguar një borxh prej 100 e ca milionësh vetëm nga bizneset në vitin 2016, në 6 mujorin e dytë të 16-ës kur ato kaluan tek bashkia e madhe. Kështu qënë llogjikën tonë jemi munduar të tregohemi sot dhe me biznesin, dhe me problematikat që kemi dhe më një buxhet që është rritur 13 %. Ku unë realisht projekti afatmesëm që kemi nga 22-25 i orientuar dhe nga qeveria dhe nga mudësitë që kemi nuk e kalon më shumë nga 2.5-3 %. Ne kemi bërë një hov të jashtëzakondshëm. Sa do të arrimë? Shpresoj që ndoshta dhe me këto masa që kemi marrë të bëjmë diçka të mirë që dhe investimet të përputhen dhe për të realizuar pikërisht ato probleme që kemi pas me pastrimin, me ndriçimin, me gjelbërimin për t'i ofruar sepse tarifat i kemi rritur në atë masë të ulët duke pas burime të tjera, siç kemi bërë dhe me plazhet që sot arkëtojmë afërsisht 120 milion lekë të reja nga plazhet, që përdoren për t'iu shërbyer qytetarëve për pastrim, ndriçim dhe gjelbërim.

Unë ju bëra një pasqyrë, unë kam shumë pasi u bëra goxha vite që e njoh këtë sektor. Këto janë mundësitë deri më sot për të bërë me një ide, që perspektiva që kemi ...

Morena Boja : Ju falenderoj për përshkrimin e pasqyrimin e buxhetit, por siç e thashë referuar këtij raporti të mëparshëm që “Ne” morëm na u tha që bashkia e Durrësit varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga transfertat qeveritare, pra nga qeverisja qendrore dhe pyetja ime lidhej pikërisht me këtë : Ju a kemi një plan ?

Ju thatë që keni një rritje 13 % të buxhetit. Pyetja është: Kjo rritje 13 % e buxhetit vjen si rezultat i riformimit të sistemit të taksave vendore apo vjen si rezultat i aktorëve të tjerë që janë pjesë e buxhetit gjatë rritjes së tyre?

Dhe diçka tjetër Ju përmendët pjesën e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve, që për hir të vërtetës siç e dimë zë peshë shumë të madhe në buxhetin e bashkisë së durrësit dhe të ardhurat që mbledhen nga mbetjet, pra nga taksat janë shumë të ulëta në krahasim me gjithë shpenzimet që bëhen. A nuk mendoni se do të ishte më korrekte që ato biznese që kanë një nivel më të lartë ndotje të paguann më shumë? Pra ju thatë pak më parë që një farmaci më parë paguante sa një byrektore, që në opinionin tim nuk është e drejtë.

Luan Dajko : Më fal .

Morena Boja: Duhet të shikohet sistemi i taksimit për t'i dhënë mundësinë bashkisë të mbledh sa më shumë ardhura. Pra nuk mund të taksohet njësoj një hotel. Po.

Luan Dajko: E para njëherë që jemi rritur 13% nga të ardhurat e veta. Buxheti i mëparshëm ka qënë 1 miliard e 794 milion lekë dhe tashi ka shkuar 2 miliard 027, 023 milion lekë. 13 % janë të ardhurat nga burimet e veta. Me transfertat parashikojmë, në raport Ne ruajmë raportin 60 me 40, por i pritshmi që parashikojmë mund të kaloj dhe vlerën e asaj, sepse qeveria na ka borxhe normalisht me pozicionin që kemi duke mos marr me basetet që zotërojmë, por po ju them vetëm një gjë Porti i Durrësit është 15 milion lekë borxh, si subjekt, se pse është akoma në gjyq e jo më me konçesionet që jep e nuk paguan. Do një përkrahje se “Ne” nuk e kemi mbështetjen si bashki më parë dhe është një e ardhur e jashtëzakondshme, e shikon me transfertat specifike, e shikon me të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuaras. Shikoj që planifikimi, që ka bërë për këtë vit rreth 4 miliardë e 560 milion lekë është më shumë sesa të ardhurat tona edhe pse jemi rrit 13 %, që do të thotë që qeveria duhet të rris dhe transfertat e tjera për t'i shërbyer qytetit me probleme të tjera që ka.

E dyta që ishte, pra 13 % ishte të ardhurat e veta. Kemi bërë një sistemim të mirë të taksave, një luftë kundër informalitetit për të realizuar 13 % më shumë nga të ardhurat e veta të bashkisë, nga taksat kryesisht, 90 %.

Sa për punën e pastrimit të tyre, në asnjë bashki, përveç atyre që marrin transfertat nuk realizohen shpenzimet me të ardhurat. “Ne” kemi bërë të mundur dhe po bëjmë një studim dhe arritëm tek një planifikim afatmesëm të buxhetit, që mendojmë që gjithë subjektet që kanë ndotur më tepër, gjithë subjektet që bëjnë, pasi ka dhe një problem, nëse më ndiqni, ka një problematik që përveçse paguajnë taksat në bashki realizojnë dhe shërbimet personale për ata që ndotin më shumë janë të lidhura me firmat private dhe nuk krijojnë 5 lekë në bashkinë e madhe, në bashkinë e madhe gjithmonë, se duhet t'i ofrosh shërbim nga Ishmi deri te Shkëmbi i Kavajës. Këtë vit kemi bërë një planifikim shumë të mirë edhe në parashikimin që kemi për taksat e pastrimit, për tarifën e pastrimit, të gjitha do të mbulojnë sipas ndotjes që bëjnë, sipas realizimeve që kanë, dhe sipas mundësisë për të mos rënduar bizneset, por për të qënë gjithmonë pranë tyre si partner.

Morena Boja : Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit z. Dajko.
Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët?

Etleva Budini : Kryetar kisha diçka .

Ani Dyrmishi : Po .

Etleva Budini : Në drejtim të këshillit bashkiak siç jeni në dijeni .

Luan Dajko : Për mua është ?

Etleva Budini : Jo , më fal s'ka lidhje fare.

Kanë ardhur 2 kërkesë ankesa. E para është një kërkesë-ankesë nga një banor, nga një familje që ka qënë pronare në pallatin “Ahmet Dakli”, Pallati “Lura”, siç i themi “Ne”, dhe tjetra është kërkesë-ankesë nga banorët, e firmosur nga 25 familje të pallatit me 41 apartamente, të pallatit 12 katësh në njësinë administrative nr.3, rruga “Kadri Pirro”.

Meqenëse kjo mbledhje përfundon këtu dhe këtu nuk, materialet e kësaj mbledhje do publikohen, doja që qytetarët që janë ankuar të kenë një informacion se çfarë po ndodh me kërkesat e tyre.

Lidhur me ankesën e familjes, që është banuese në pallatin “Ahmet Dakli”, e cila nuk ka marrë një përgjigje nëse është fituese apo jo ndërkohë që përfundon objekti i ri, stafi i bashkisë për shkak të kohës së shkurtër nuk na vuri dot në dispozicion materialet që kërkuam. Kështu që besoj se do të trajtohet në mbledhjen e ardhshme ose shpresojmë në mbledhje jashtë radhe.

Ndërsa për kërkesën e banorëve të pallatit 12 katësh, në njësinë administrative nr.3, të cilët ankohen dhe kanë një informacion që për pallatin mund të merret vendim nga bashkia për demoloim të ndërtesës ku ata kanë apartamentet e tyre. Kanë sjell kërkesë-ankesën dhe bashkëngjitur dhe një tuf dokumentash. Rasti është, aq sa është sensitiv për banorët e këtij pallati është edhe specifik, prandaj kërkon pak më shumë kohë. Kryetari i Këshilli ja ka adresuar Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike si dhe Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike për trajtim. Kërkon një trajtim më të gjatë në kohë për shkak se është specifik si rast. “Ne” u mbledhëm me anëtarët e 2 Komisioneve, u mbledhëm para mbledhjes në orën 11:30 dhe e diskutuam, por ka nevojë për një trajtim më specifik deri në mbledhjen e ardhshme.

Kështu që kjo ishte sa për informacion. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Ju falenderoj për seriozitetin që keni marrë për kërkesat që i drejtohen këshillit bashkiak nga qytetarët e qytetit tonë. Në vazhdimësi ju i keni marrë e do të merrni dokumentacionet nga bashkia për t'i kthyer një përgjigje të interesuarve.

Përsa i përket mbledhjes së sotme nuk e di nëse ka ndonjë pyetje tjetër?

Nuk ka.

Nëse zëvendëskryetari i bashkisë ka diçka për të shtuar.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar.

Vetëm zonjës Budini doja t'i thoja se nëse ka nevojë për dokumentacion shtesë nga ana e bashkisë jemi të hapur që t' jua vëmë në dispozicion .

Etleva Budini : Po, faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Jani.

Faleminderit të gjithëve. Faleminderit të pranishmëve.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga Sekretaria e Këshillit.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 11 (njëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI